








BOTIMET M&B

BOTIME 2025

 Rruga "Siri Kodra", P. "Planet X", Zona.Kad.8360, N.6, Tiranë
 0692068603  0686508441  mbbotime@gmail.com
 www.mbbotime.al  Botimet M&B  botimetmb

Përmbajtja

Poezi 4

Prozë 13

Shkrime, kujtime,

hulumtime 22

Kultura popullore 37

Sociologji

psikologji 40

Histori 46

Letërsi klasike 51

Gjeopolitikë 53

Fjalorë 56

Kulinari 5

BOTIMET M&B

Botimet M&B kanë filluar veprimtarinë e tyre pas vendimit të Gjykatës së Tiranës nr. 21939, datë 9 maj 2002.


Fillimisht ushtruan veprimtarinë si studio grafike dhe prej datës 6 nëntor 2006, po me vendim të Gjykatës së Tiranës, kanë shtrirë veprimtarinë edhe në fushën e botimeve.

Fusha kryesore e veprimtarisë është në dizenjimin dhe parapërgatitjen për shtyp të të gjithë gamës së botimeve, duke sjellë cilësi dhe standarde bashkëkohore.

Botimet tona janë fokusuar kryesisht te autorët shqiptarë, një pjesë e tyre jetojnë jashtë vendit.

PUTHLUTJA IME

Alban Bala



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928820969

Faqe: 268

Çmimi: 1000 lekë

Hardcover: 1300 lekë

POEZI

Çdo libër është një pasqyrë. Historitë tona njerëzore shfaqin përmes tyre fizionominë e asaj kohe, e cila nisët për t'u bërë kujtesa e të gjithëve edhe pse kaqenë thjesht jeta e një ose dy njerëzve – krejt të padukshëm në këtë kozmos të zhurmsëm njerëzor.


Kësisoj librat shndërrojnë në dije universale përvojat më të imta, ndjesitë më të heshtura, më të fshehta, më të singërta.

Në këtë fjalë të fundit unë dua të them vetëm dy detaje që poezia – sado fjalëhollë që është, nuk i rrëfen dot. E para është vërtetësia. E dyta është natyrshmëria. Poezia e vërtetë është ajo që nuk vjen si poezi, por si mënyrë të jetuari. Shumë prej këtyre vargjeve janë në themel biseda njerëzore, janë çaste personale, shkëmbime të pandërprera idesh dhe gjendjesh, janë përshëndetje të mëngjesit dhe mbrëmjes njerëzore më të natyrshme që ekziston.

Nëse mund ta them me zë të lartë: një libër nuk shkruhet. Ai jetohe.

OPIUM

Artan Gjyzel Hasani



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851451

Faqe: 80

Çmimi: 500 lekë

POEZI

OPIUM

kur memecët fitojnë lirinë e fjalës
bota gjithnjë bëhet shurdhe,
ndaj unë i gëzohem të drejtës për të
heshtur
në jetën time të zhurmshme
dhe ulem e shkruaj....
por jo çdo varg shkruhet që të lexohet,
ndonjë duhet thithur thellë me hundë
derisa të mpihesh dhe të bëhesh gur,
kalldrëm toksik brenda venave të
përmbytura
me gjak mendjeje të vjedhur nga zemra
helmi im të është bërë oksigjen
për rrugë frymëmarrjesh të ndaluara
dhe tashmë ti nuk vdes më
të paktën jo nga frika...
thithi me hundë vargjet e mia,
jam vrasësi i vdekjes
i shpallur në kërkim...
varmihësi i jetëve të pajetuara...

MISTER

Ailda Mëngjesi



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851383

Faqe: 108

Çmimi: 700 lekë

POEZI

Pezitë e këtij libri janë një udhëtim nëpër labirintet e dashurisë, kohës dhe shpirtit njerëzor.

Ailda Mëngjesi e përdor poezinë si pasqyrë ku reflekton ndjeshmëri të thella, duke ndërthurur misterin hyjnor me emocionet tokësore. Vargjet janë të ëmbla e të qeta si një mëngjes pranveror, herë të mprehta e therëse si thyerjet e brendshme të njeriut.

Dashuria shfaqet si shpëtim e si plagë, si kujtim dhe si ëndërr që nuk shuhet kurrë. Koha, fati dhe besimi i japin poezisë një dimension filozofik, ndërsa muzikaliteti i vargut e bën poezinë të rrjedhë natyrshëm.

Ky libër është një ftesë për të medituar mbi misterin e jetës dhe bukurinë e jetës që shpesh harrojmë të jetojmë.

PRINCI I MELANKOLISË

Thimi Gogo



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851437

Faqe: 208

Çmimi: 800 lekë

POEZI

(Ditar i braktisjes dhe i harrimit)

Kjo vepër, edhe pse e trishtë, është një letër dashurie ndaj botës, ndaj vetes, ndaj të gjithë njerëzve.

Jo vetëm atyre që kam njohur, por edhe atyre që do të njoh, apo atyre që nuk kam njohur asnjëherë.

Çfarë e ndezi vallë zjarrin shfarosës të trishtimit në mua?

Harresa, zhgënjimi, deziluzioni?

Nuk është asnjëra prej këtyre.

Çdo shpirt njerëzor është unik, i papërsëritshëm, i paimitueshëm, ja përse meriton të shihet, të preket, të adhurohet, të dëgjohet.... **TË DUHET!**


Ky fakt është pikënisja dhe pikë mbërritja e gjithçkaje.

Këto vargje janë thjesht hapat e mi të parë poetikë në rrugën e pafundme e të përjetshme drejt dashurisë...

A jeni gati t'i bashkoheni këtij rrugëtimi me mua? - Thimi Gogo

MOS I THUAJ LAMTUMIRË BOTËS

Meri Myftari



POEZI

“Mos i thuj lamtumirë botës” është një udhëtim nëpër labirintet e shpirtit njerëzor, ku dhimbja, dashuria dhe qëndresa përzihen në një poezi të zhveshur nga zbulimet, por të mbushur me dritë të brendshme.

Në to gjen një zë femëror të fortë dhe të brishtë njëkohësisht, që sfidon heshtjen, zhgënjimin dhe frikën, duke kthyer përvojat personale në përjetim universal.

Botimet M&B

Publikimi: 2025


ISBN: 9789928851192

Faqe: 104

Çmimi: 700 lekë

FYTYRAT E KOHËS

Meri Myftari



POEZI

“Fytyrat e kohës” është një udhëtim poetik që nuk kërkon zburime, por të vërteta të zhveshura deri në palcë. Në këto faqe, fjala nuk është thjesht fjalë: ajo është thikë që pret, plagë që dhemb, shpresë që merr frymë edhe në tym. Poezia e këtij libri nuk është për ata që duan t’i ikin dhimbjes, por për ata që guxojnë t’i ulen përballë, ta shohin në sy dhe ta kthejnë në art.

Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851277


Faqe: 160

Çmimi: 1000 lekë

Shqip - Anglisht

SHPIRT I TRAZUAR

Gjergji Dushku



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928820785

Faqe: 182

Çmimi: 1000 lekë

POEZI

Çdo libër është një pasqyrë. Historitë tona njerëzore shfaqin përmes tyre fizionominë e asaj kohe, e cila nisët për t'u bërë kujtesa e të gjithëve edhe pse ka qenë thjesht jeta e një ose dy njerëzve – krejt të padukshëm në këtë kozmos të zhurmshëm njerëzor.

Kësisoj librat shndërrojnë në dije universale përvojat më të imta, ndjesitë më të heshtura, më të fshehta, më të sinqerta.

Në këtë fjalë të fundit unë dua të them vetëm dy detaje që poezia – sado fjalëhollë që është, nuk i rrëfen dot. E para është vërtetësia. E dyta është natyrshmëria. Poezia e vërtetë është ajo që nuk vjen si poezi, por si mënyrë të jetuari. Shumë prej këtyre vargjeve janë në themel biseda njerëzore, janë çaste personale, shkëmbime të pandërprera idesh dhe gjendjesh, janë përshëndetje të mëngjesit dhe mbrëmjes njerëzore më të natyrshme që ekziston.

Nëse mund ta them me zë të lartë: një libër nuk shkruhet. Ai jetohe.

ISHTE KOHA PËR POEZI

Ilia Kristo



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928885152

Faqe: 72


Çmimi: 600 lekë

POEZI

Ky vëllim poetik lindi nga dashuria për qytetin, njerëzit dhe kujtimet që mbeten të pashlyera në shpirt. Poezitë janë një ftesë për të përjetuar emocione të vërteta dhe për të parë botën përmes ndjenjave. Çdo varg është një kujtim, një frymë dhe një copëz shpirti që merr jetë në letër. Në këtë përmbledhje poetikë janë disa poezi të zgjedhura për dashurinë, për vjesh tën dhe për Korçën - vendlindjen e poetit.

KATUNDI MES MALESH

Ramiz Gjini



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851093

Faqe: 168

Çmimi: 800 lekë

TREGIME

Tregimet e Ramiz Gjinit nuk vijnë me madhështi epike për të prekur lexuesin, ato vijnë me situata njerëzore, krejt të heshtura, me detaje të holla dhe fine, dhe kur tregimi mbaron, të bën për vete, sikur të ishte pjesë e rrëfimit. Kështu ndodh me këto tregime të këtij vëllimi, që vijnë të shkruar me një gjuhë të pasur, me një frazë të qartë - shpesh e kursyer, por që përcjellin shumë ngarkesë emocionale dhe shumë kuptim.

Pesëmbëdhjetë tregimet e këtij vëllimi janë përzgjedhur me kujdes, që e sjellin Ramiz Gjinin në prozën e shkurtër shqipe, me një frymë bashkëkohore dhe mesazhe universale.

NJERIU QË SHKRUANTE NË VARREZA

Kliton Nesturi



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851208

Faqe: 304

Çmimi: 1200 lekë

ROMAN

“Ky është romani më i mirë i shkruar nga një autor bashkëkohor shqiptar mbi kotësinë e jetës në periferi, paradoksin dhe misterin e përditshmërisë dhe që rrëfimtari zotëron mjeshtri për të mbajtur lexuesin në tension deri në faqen e fundit.” — Dr. Albert Gjoka

“Me romanin “Njeriu që shkruante në varreza”, Kliton Nesturi na vë përpara një rrëfimi të ngjeshur ku gërshetohen frika, misteri dhe plagët e fshehta të një komuniteti. Me një narracion të rrjedhshëm e të mprehtë dhe me personazhe të gdhendura me kujdes, autori shpalos absurditetet dhe krizat morale të shoqërisë shqiptare bashkëkohore. “Njeriu që shkruante në varreza” është një udhëtim në thellësitë e shpirtit njerëzor dhe një pasqyrë e realitetit që e jetojmë, por që nuk guxojmë ta shohim.” —

Zyrafete Shala

PENG I NJË MENTALITETI

Anxhela Peza



Botimet M&B
Publikimi: 2025
ISBN: 9789928851482
Faqe: 170
Çmimi: 1000 lekë

ROMAN

“Peng i një mentaliteti” - një rrëfim i thellë psikologjik dhe emocional që ndërthur kujtesën, identitetin dhe përplasjen mes traditës dhe modernes. Në qendër të tij qëndron një grua që, pas vitesh emigrimi në Angli, kthehet në vendlindje për t’u përballur me plagët e së shkuarës dhe për të reflektuar mbi rrënjët që e kanë formuar. Përmes kujtimeve, legjendave familjare dhe ndërthurjes së reales me mistiken, romani shpalos historinë e brezave që mbeten “peng” i një mentaliteti patriarkal, por edhe të përpjekjes për çlirim shpirtëror e vetëdijesim.

“Peng i një mentaliteti” - një roman për gruan që kërkon paqe me veten dhe me vendin e origjinës — një udhëtim i brendshëm drejt lirisë.

DEPRESIONI KUQ E ZI

Leonard Veizi



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928820877

Faqe: 380

Çmimi: 1000 lekë


PUBLICISTIKË SATIRIKE

Bota e letrave, ashtu si dhe botët e tjera, mund të krahasohet me një labirint të gjatë, ku ndeshesh me pengesa të panumërta e të papritura që të sfidojnë në çdo kthesë.

Ashtu si ai labirint, edhe bota e të shkruarit më sfidon me pasqyra që më tregojnë jo vetëm fytyrën time, por edhe kufijtë e krijimit. Çdo fjali është një kthesë e re; çdo paragraf, një udhëkryq. Dhe ndërsa kërkoj rrugën e daljes, ndoshta ajo që ka më shumë rëndësi nuk është të dal, por të vazhdoj të lëviz brenda saj, duke provuar, duke u përplasur, duke sfiduar dhe, mbi të gjitha, duke mos u ndalur.

DEPRESIONI I BARDHË

Leonard Veizi



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851246

Faqe: 566

Çmimi: 2000 lekë


LETËRSI INDUSTRIALE. SPROVA - PUBLICISTIKË LETRARE

Bota e letrave, ashtu si dhe botët e tjera, mund të krahasohet me një labirint të gjatë, ku ndeshesh me pengesa të panumërta e të papritura që të sfidojnë në çdo kthesë.

Ashtu si ai labirint, edhe bota e të shkruarit më sfidon me pasqyra që më tregojnë jo vetëm fytyrën time, por edhe kufijtë e krijimit. Çdo fjali është një kthesë e re; çdo paragraf, një udhëkryq. Dhe ndërsa kërkoj rrugën e daljes, ndoshta ajo që ka më shumë rëndësi nuk është të dal, por të vazhdoj të lëviz brenda saj, duke provuar, duke u përplasur, duke sfiduar dhe, mbi të gjitha, duke mos u ndalur.

GËNJESHTARJA E PAFAJSHME

Ari Mari



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851291

Faqe: 368

Çmimi: 1000 lekë

ROMAN

Një mori intrigash zhvillohen mes mureve të Pallatit Mbretëror të Meusit, stisur nga një urrejtje e ushqyer mes gjakut të njejtë, por të hidhur të të dy motrave, nën një dinamikë të atmosferës kalorësiake, potencialitetit të dialogut dhe karakterit tipizues të personazheve... konflikte ku ndjenja nuk njih arsyen, pamëshira është zhdukur, sikundër shumë të tjerash e kurthet pasojnë njëra-tjetrën, përmes ligjëritimit imperativ befasues, duke bërë shpatat të prekin vdekjen..

VDEKJA E ENGJËLLIT

Shaqir Skarra



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851390

Faqe: 336

Çmimi: 1000 lekë


TREGIME DHE NOVELA

Një nga vlerat më të spikatura të kësaj përmbledhjeje është mënyra se si ndërtohet rrëfimi. Autorit i mjafton një detaj, një shprehje popullore apo një ngjarje e vogël, për të ngritur mbi të një tregim që i ngjan një tabloje të gjallë. Narrativa është lineare, e kthjellët dhe pa artificë të panevojshme; kjo e bën lexuesin të ndjekë me lehtësi ngjarjen, por njëkohësisht ta përjetojë atë me intensitet emocional. Dialogët janë të natyrshëm, të mbushur me gjuhën e gjallë popullore, duke e sjellë atmosferën e vendit dhe kohës si të ishte dëshmitar vetë.

Thjeshtësia e gjuhës është një tjetër element që i jep forcë tregimeve. Ajo nuk është një thjeshtësi e varfër, por një qartësi që buron nga përvoja e të shkruarit “me zemër në dorë”. Përmes fjalëve të zakonshme, autori arrin të shprehë gjëra të mëdha – dhimbjen, krenarinë, tradhtinë, besën – duke i bërë të prekshme për çdo lexues. Përshkrimet nuk mbingarkohen me zburime të tepërta; ato janë të matura, por gjithmonë të ngarkuara me emocion dhe me figuracion të gjallë. Kjo mënyrë e të shkruarit krijon një bukuri të veçantë letrare, ku e përditshmja kthehet në art.

SHTEGTARI

Pilo Zyba



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851185

Faqe: 340

Çmimi: 1000 lekë

TREGIME DHE NOVELA

...

Më pas dolëm në një livadh. Në cep të tij një man i madh.

- Të kujton gjë ky man? - po buzëqeshte Gjergji me hutimin tim. - I shikon këto tela e këto shkarpa. Mban mend? I ke vënë ti...


Çudi, shtrati që kisha bërë në krahët e tij ishte ngjitur lart.

Pema qe rritur, duke mbajtur në supe dhe kujtimet e mia. Telat që kisha lidhur dikur nëpër degë e kishin pushtuar të tërin, qenë bërë njësh me të. Mbi shtratin e shkarpave, trungjet dhe degët e thata ngjanin çuditërisht si krevat. Hipa lart dhe i preka me dorë. Degët e thata më ngjanë si eshtrat e një të vdekuri. Kishin humbur gjithçka, forcën, gjallërinë, por brenda heshtjes së tyre të vdekur fshihnin atë, që unë nuk mund ta hiqja lehtë nga kujtesa. Një kitarë që binte në jehonën e degëve të manit e humbiste në humnerën e kujtimeve.

Fragment
nga tregimi "Shtegtari"

KOHA E DY PANDEMIVE

Daut Gumeni



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851475

Faqe: 350

Çmimi: 1000 lekë

PUBLICISTIKE

“Koha e dy pandemive” i Daut Gumenit është një përmbledhje refleksionesh dhe shkrimesh publicistike që krahasojnë dy “sëmundje” të kohës sonë: pandeminë biologjike të Covid-19 dhe pandeminë shoqërore e morale që autori e quan “Kovigja-90”, e lindur nga tranzicioni politik pas viteve ’90.

Me një gjuhë të mprehtë dhe ironike, Gumeni analizon shthurjen e vlerave, shtrembërimin e së vërtetës në media, degradimin e politikës dhe humbjen e idealeve qytetare. Ai e sheh shoqërinë shqiptare si viktimë të dy plagëve njëherësh — frikës fizike nga virusi dhe kalbëzimit moral të institucioneve e pushteteve.

Në thelb, libri është një thirrje për kthim te ndërgjegjja, e vërteta dhe dinjiteti njerëzor, si mënyra e vetme për t’u shëruar nga “pandemitë” që e kanë plagosur shoqërinë.

VISE E VITE DHE MIQ E SHOKË

Prof. Dr. Hajri Shehu



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928820884

Faqe: 410


Çmimi: 2000 lekë

KUJTIME DHE MBRESA

Prof. Hajri Shehu ua kushton këtë libër atyre burrave dhe atyre grave, që e pritën me tërë bujarinë e tyre e me tërë përkujdesjen e tyre në ekspeditat e tij gjuhësore dhe i dhanë fjalën e bukur shqipe e shprehjen e bukur shqipe. “Kam dashur të them diçka – më shumë si punë kujtimesh për vise, vite e njerëz. Janë vise, vite e njerëz që kanë lënë shumë gjurmë tek unë. Për mirë, sigurisht. Prandaj i ruaj e i kujtoj. Por them diçka sepse ka ende shumë e shumë për të thënë. Me respekt të madh e vlerësim të lartë do të shkruaj edhe për kolegët e koleget. Por në fletë të tjera, më pas, në një libër tjetër. Ajo që mund të them tani është kjo: Shumë kam mësuar nga kolegët e koleget. Shumë kam parë te puna e tyre e madhe dhe te sedra e tyre e madhe.

JETËSHKRIME DHE VEPRA MIQSH E SHOKËSH TË SHQUAR

Prof. Dr. Hajri Shehu



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928820778

Faqe: 462

Çmimi: 2000 lekë

KUJTIME DHE MBRESA

Çdo libër është një pasqyrë. Historitë tona njerëzore shfaqin përmes tyre fizionominë e asaj kohe, e cila nisët për t'u bërë kujtesa e të gjithëve edhe pse ka qenë thjesht jeta e një ose dy njerëzve – krejt të padukshëm në këtë kozmos të zhurmshëm njerëzor.

Kësisoj librat shndërrojnë në dije universale përvojat më të imta, ndjesitë më të heshtura, më të fshehta, më të sinqerta.

Në këtë fjalë të fundit unë dua të them vetëm dy detaje që poezia – sado fjalëhollë që është, nuk i rrëfen dot.

E para është vërtetësia. E dyta është natyrshmëria. Poezia e vërtetë është ajo që nuk vjen si poezi, por si mënyrë të jetuari. Shumë prej këtyre vargjeve janë në themel biseda njerëzore, janë çaste personale, shkëmbime të pandërprera idesh dhe gjendjesh, janë përshëndetje të mëngjesit dhe mbrëmjes njerëzore më të natyrshme që ekziston.

Nëse mund ta them me zë të lartë: një libër nuk shkruhet. Ai jetohe.

HAPJA E PERDES SË HEKURT

Ilia Zhulati



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851086

Faqe: 326

Çmimi: 1000 lekë

Çmimi: 1500 lekë (hard cover)

HISTORIA E PATREGUAR E RIVENDOSJES SË MARRËDHËNIEVE DIPLOMATIKE SHQIPËRI-SHBA


Në vitin 1985, pas vdekjes së Enver Hoxhës, një diplomat i ri shqiptar u takua fshehurazi me një profesor amerikan në Nju Jork – duke nisur kështu gjashtë vite diplomacie të fshehtë dhe me rrezik të lartë.

Si përfaqësues i Shqipërisë në OKB, në një kohë kur regjimi e konsideronte Amerikën si armikun më të madh, Ilia Zhulati rrezikoi gjithçka për të ndërtuar ura aty ku, për breza të tërë, kishin qëndruar vetëm mure. Misioni i tij i fshehtë – i panjohur madje edhe për shumicën e zyrtarëve shqiptarë – do të ndihmonte në përfundimin e izolimit ekstrem të vendit dhe do të transformonte përgjithmonë peizazhin gjeopolitik të Ballkanit.

Ky rrëfim i drejtpërdrejtë ju çon pas dyerve të mbyllura – nga takimet e fshehta në Nju Jork te negociatat e tensionuara diplomatike në Vjenë – duke zbuluar lojën diplomatike me rrezik të lartë që, në fund, rivendosi marrëdhëniet midis dy kundërshtarëve historikë.

LIFTING THE IRON CURTAIN

Ilia Zhulati



Botimet M&B

Publikimi: Tetor 2025

ISBN: 978-9928851031

Faqe: 326

Çmimi: 1000 lekë

Çmimi: 1500 lekë (hard cover)

THE UNTOLD STORY OF THE RESTORATION OF DIPLOMATIC RELATIONS BETWEEN ALBANIA AND THE UNITED STATES

“Even in the darkest times, when paranoia reigned and bunkers outnumbered schools, the light of the human spirit could not be extinguished.”


For over four decades, Albania stood alone—Europe’s most isolated nation. Then in 1985, after dictator Enver Hoxha’s death, a young Albanian diplomat met secretly with an American professor in New York, beginning six years of dangerous backchannel diplomacy.

As UN representative for a regime that viewed America as the enemy, Ilia Zhulati risked everything to build bridges where walls had stood for generations. His clandestine mission—unknown even to most Albanian officials—would help end his homeland’s extreme isolation and transform the Balkans forever.

This gripping firsthand account takes you behind closed doors—from covert meetings in New York to tense diplomatic negotiations in Vienna—revealing the high-stakes chess game that ultimately restored relations between two longtime adversaries.

GJUHA SHQIPE, HISTORIA DHE E TANISHMJA

Xhafer Martini



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851079

Faqe: 308

Çmimi: 1000 lekë

GJUHËSI

“Gjuha shqipe, historia dhe e tanishmja” është një studim i thelluar, një akt dashurie dhe guximi intelektual ndaj gjuhës sonë amtare. Xhafer Martini e sheh shqipen jo thjesht si një sistem fjalësh, por si një strukturë identitare kombëtare, si histori e gjallë e mbijetimit tonë.

Libri trajton edhe identitetin autokton të shqiptarëve, duke përfshirë tezën e prejardhjes nga Pellazgët dhe qëndrimin ndaj huazimeve sllave apo ndikimeve greke, romake, osmane. Në thelb, kjo vepër është një apel për ruajtjen, pasurimin dhe pastrimin e gjuhës shqipe në kohët moderne.

Ajo çfarë mbetet si mesazh i fortë nga kjo vepër është: Gjuha është e të gjithëve. Ajo nuk i përket vetëm politikës, gjuhëtarëve, apo pushteteve, por çdo shqiptari që flet, mendon dhe krijon në të. Kujdesi për shqipen është kujdes për vetveten.

PORTRETE

Xhafer Martini



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851116

Faqe: 160

Çmimi: 800 lekë

BIOGRAFI

“Portrete” i Xhafer Martinit është një libër që na kujton se pas çdo emri ka një jetë, një shpirt, një histori që meriton të tregojë veten. Nga figurat botërore si Linkoln, Tolstoi, Balzaku, e deri te shokët, nxënësit, mësuesit dhe njerëzit e zakonshëm, Martini i sjell në këtë libër si një galeri portretesh të gjalla, të ndërtuara me fjalë.


Nuk ka rend kronologjik apo hierarki; portretet rrjedhin njëri pas tjetrit si në një rrëfim jete, me teknika të ndryshme: kujtime, reflektime, elegji, prozë poetike. Në thelb, ai nuk shkruan për të famshmit – por për njerëzit që kanë lënë gjurmë në të.

“Portrete” është një homazh për jetën dhe njerëzit. Një përpyetje për t’i dhënë përjetësi atyre që janë larguar dhe atyre që jetojnë ende brenda nesh.

Në këtë libër do të gjeni portretet për: Abraham Linkoln, Honore De Balzak, Leon Tolstoi, Frederik Niçe, Xhek London, Arshi Pipa, Bajram Mata, Qemal Çadri, Islam Çenga, Rufat Spata, Hysen Repa, Franz Shubert, Portret qyteti, Esenini, Mefaili, Nin Rajta, Ndoc Gjetja.

NAZIBOLSHEVIZMI - LETËRSIA DHE ARTET

Bashkim Trenova



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928820747

Faqe: 248

Çmimi: 1500 lekë


STUDIM LETRAR

Historianë, filozofë politikë, intelektualë të shkollave apo dhe të pozicioneve të ndryshme, i kanë kushtuar mijëra e mijëra faqe, vëllime të tëra, studime dhe artikuj krahasimit midis nazizmit dhe komunizmit. Përgjithësisht, në botimet dhe studimet e tyre, qëndrohet në kontrollin policor të shoqërisë nga këta diktatura, në rolin e hierarkisë shtetërore diktatoriale, të kreut të shtetit, si mbytës të mendimit të lirë, në vendin e gjithëpranishëm të propagandës zyrtare në shoqëri, në masakrat masive dhe në rrjetin e kampeve të përqendrimit, në veprimtarinë e policisë, NKVD në BRSS (më pas KGB) dhe të Gestapos në Rajhun e Tretë...

Objekti i këtij botimi është i kufizuar. Ai kërkon thjesht të "rindërtojë" vetëm një pjesë të rëndësishme të jetës së shoqërisë gjermane dhe sovjetike përgjatë diktaturës naziste në Gjermani dhe asaj bolshevike në Rusi.

MORGU I GJALLË

Kristaq Balli




Botimet M&B
Publikimi: 2025
ISBN: 9789928851253
Faqe: 512
Çmimi: 2000 lekë

BIOGRAFI

“Morgu i Gjallë” - një koncept alegorik i arkivave të shumta, fondeve, rezervateve të mëdha dokumentare, fotografike, apo negativave të tyre të publikuara, ose jo në organet e mëdha mediatike amerikane, të muzeve të famshëm historikë, apo artist pamor si “The New York Times”, “LIFE-TIME”, “MOMA”, “Instituti Smithsonian”, etj., që, pas një shekulli “të vdekura”, kanë filluar të ringjallen, të rijetësohen, gjatë epokës së revolucionit teknologjik digjital, duke evidentuar vlera të reja shoqërore, estetike e autoriale. Një procesi të tillë vitalizues iu janë kushtuar edhe autorëve fotografë apo fotoreporterë shqiptaro-amerikanë të këtij libri, duke na shfaqur në pah individualitete krijuese të kalibrit ndërkombëtar.

SHKRIME, KUJTIME DHE HULUMTIME GJEOLIGJIKE

Vesel Hoxha



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851109

Faqe: 586

Çmimi: 2500 lekë

KUJTIME

Në librin e profesor Vesel Hoxhës do të gjeni shkrime me problematika të larmishme jetësore e shkencore nga më të ndryshmet me interes për lexuesin; kujtime nga koha e studimeve në Teknikumin e Minierave dhe të Gjeologjisë në Prrenjas; kujtime gjatë kohës si mësimdhënës në Fakultetin e Gjeologjisë dhe të Minierave (një dëshirë e kahershme e plotësuar për autorin), krahas punës në Institutin e Gjeoshkencave të UPT-së; kujtime e të dhëna shkencore gjatë hulumtimeve gjeologjike në terren në veri e në jug të Shqipërisë për evaporitet, me profesor Ibrahim Milushin; foto interesante mineralesh e shkëmbinjsh me dukuri tektonike etj., nga bota e pa fundme e tyre që të mrekullojnë; intervista me bashkëfshatarët e tij; refleksione për personalitete atdhetare e politike; gjeomonumente e peizazhe; rreth drejtshkrimit të gjuhës shqipe; citime nga vepra të mendjeve të ndritura; fjalë të urta etj. Në fund të librit do gjeni listën e punimeve shkencore të deritanishme dhe një jetëshkrim të shkurtër të autorit. – Nga prof. Adil Neziri

FISI DACI I ZOGJEVE TË DIBRËS

Bashkim Lleshi



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928820693

Faqe: 266

Çmimi: 1500 lekë

BIOGRAFI

Ky liber i kushtohet fisit Daci në fshatin Zogje të Dibrës. Autori, Bashkim Lleshi është përpjekur të japë një tablo sa më të gjerë për vendndodhjen e fshatit, lagjet dhe fiset, toponimet, tokat arë, përrejtë e burimet, banorët më të vjetër: Suti, Kaja, Lila, Mena deri tek Markja, Leka, Lleshi, Krrusa, Daci, Hasani, Caka e Toçi. Në mënyrë të detajuar përshkruhet fisi Daci në lagjen Kodras të fshatit Zogje të Grykës së Vogël, lëvizjet në Shupenzë, Gjoricë, Dibër e Madhe, Tiranë etj., ku kanë migruar për një jetë më të mirë. Të dhënat për të shkruar këtë libër kanë filluar të mblidhen në fillimet e viteve 2000, gjatë kohës që autori mblidhte të dhëna për të shkruar librin e fisit Lleshi, i cili u botua në vitin 2012. Ky libër do t'i shërbejë brezit të sotëm, për t'u njohur me prejardhjen e të parëve, me punën e përpjekjet e tyre për të ardhur deri në ditët e sotme.

NJË JETË MALEVE - 7

Bashkim Lleshi



Botimet M&B
Publikimi: 2025
ISBN: 9789928820990
Faqe: 334
Çmimi: 1000 lekë

KUJTIME

Në këtë libër përshkruhet jeta dhe aktiviteti i autorit në fushën profesionale, shkencore, në fushën e botimeve, aktiviteteve shoqërore e patriotike gjatë viteve 2021- 2024.

Ky libër vjen pas 6 librave të tjerë të prof. Bashkim Lleshit me kujtime nga jeta dhe puna e tij ndër vite.

GJOLI SKAVICA KËRCËNON DIBRANËT E PËRGJUMUR

Selman Mëziu



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928820815

Faqe: 364

Çmimi: 1500 lekë

STUDIME, MEDITIME, SHKRIME PROBLEMORE


“Libri “Gjoli Skavica kërcënon dibranët e përgjumur” është një enciklopedi njerëzore, emra të përveçëm që autori i ka takuar në përshkrimin e tij enciklopedik, emra njerëzish, fshatrash, fisesh, personalitetesh me të cilët bashkohet pa ekuivok në betejën për t’i thënë JO SKAVICËS, PO VENDLINDJES.

Lexuesi, i humbur në lexim, do të takojë shumë njerëz që i ka njohur në jetë, personalitete popullore që ka pi kafe e ka dëgjuar rrëfimet e tyre, shumë fshatra që për t’i njohur, ka ecur me orë të tëra në këmbë, kroje (eh si më vjen në pamje e në buzë Kroi i Zi!), lugina, lëndina, pyje ahu, dushku e pishë, blloqe të mëdhenj frutore e kanale ujtitës që piketoheshin me karabinë gjermane...

Selman Mëziu, me punimin shkencor e enciklopedik: “Gjoli Skavica kërcënon dibranët e përgjumur”, i ka vënë kazmën digës së korrupsionit më të madh të kohës sonë, u ka dhënë shpresë dibranëve që lugina e Drinit të Zi të jetë ashtu si e ka krijuar Zoti... - *Abdurahim Ashiku*

HISTORIKU I SHKOLLËS SË MESME BULQIZË

Nafije Jella



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928820730

Faqe: 776

Çmimi: 2000 lekë

ARSIM

Ky libër është një databazë për të dhënat historiko-arsimore të veprimtarisë mësimore-edukative, ku autorja me të drejtë ndalon në pikat më kryciale, domethënëse dhe ndikim publik. Ky libër është një nderim dhe homazh për gjithë kontributorët në vite të Shkollës së Mesme Bulqizë, për gjithë komunitetin mësimdhënës dhe mësimnxënës, një libërmesazh për brezat që vijnë, një libër i shkruar me kujtime për të mos u harruar. Një monografi, e cila i kushtohet një institucioni arsimor në vite, ku kemi të dhëna statistikore, që përbëjnë një vlerë të rrallë dokumentare, por edhe mbresa dhe kujtime, vlerësime të protagonistëve dhe intervistuesve nga autorja. Shkolla e mesme Bulqizë është vatra, ku përgjatë 57-të viteve, kanë marrë dije gjenerata të tërë nxënësish në formimin e përgjithshëm dhe atë profesional. Çdo gjë ka një fillim dhe kurdoherë ka një herë të parë, kështu dhe shkolla e mesme Bulqizë, hapi dyert e saj të dijes 57 vite më parë, më 1967.

TREGIME TË RRALLA POPULLORE

Xhafer Martini



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851314

Faqe: 112


Çmimi: 500 lekë

TREGIME POPULLORE

Tregimet e këtij vëllimi janë pak të njohura për publikun, por vijnë së bashku si një histori e mençurisë popullore. Ndërsa koha e këtyre tregimeve vjen nga thellësia e shekujve, nga historia dhe tradita popullore, mesazhet që ato përcjellin janë aktuale, me zgjidhje krejt origjinale.

INDI SOCIAL I SHQIPËRISË

Pëllumb Nako



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851444

Faqe: 160

Çmimi: 1000 lekë


SOCIOLOGJI

Shkrimi i një libri është rrugëtim, është një eksperiencë që autori me bujari e ndan me publikun. Nga vet titulli Nako i hyn thellë analizës së strukturimit të shoqërisë shqiptare. Zgjedh me mjeshtëri faktet historike, duke i gërshtuar me një identitet të thellë të fiksuar ndër shekuj në fushën sociale, politike dhe ligjore. Funksionimi i shtetit dhe pushtetit është një nga sfidat që autori analizon në shumë aspekte. E drejta e pronës, si një e drejtë kushtetuese për çdo individ dhe mbrojtja e saj, përcakton kufirin e hollë, shpesh i abuzuar, midis pronës private dhe asaj të përbashkët e komunitare. Një nga sfidat që autori analizon, duke u mbështetur në studime dhe përjasje të ngashme të vendeve të tjera europiane, është funksionimi i administratës publike. Cila është “mendësia” që lëviz këtë makineri gjigante, ajo e vjetra apo ajo moderne, siç e quan Nako? Lind pyetja: mund të ketë ndryshim në fushat që autori analizon thellë? Nako, edhe këtë herë, na surprizon.

*Alketa Çoku,
psikoanaliste*

LABIRINT NË TRU

Dr. Zoje Jakaj (Xhoi) & Evans Drishti



Botimet M&B
Publikimi: 2025
ISBN: 9789928820839
Faqe: 328
Çmimi: 1500 lekë

SOCIOLOGJI

Më thuaj çfarë të bënte të lumtur kur ishe 13 vjeç? Më thuaj...”, këmbëngulte ime bijë, me sytë e skuqur nga sforcimi për të mos derdhur asnjë pikë loti. Mes zemëratës e krenarisë më kërkonte ndihmë me mënyrën e saj për ta kuptuar. Kërkonte një urë sado të vogël ku të takoheshim në mes. Por ndërsa ajo e donte këtë takim si dy 13 vjeçare, unë doja të mbërrinin si nënë e bijë. Dhe rrugës drejt tij të kryenim procese të brendshme secila të moshës e pozicionit të vet. Unë si mam i një adoleshenteje në vitin 2025, ajo si bija e dy prindërve, me adolehencë të viteve ‘90.

...


Ky libër do të të kujtojë se ke harruar si je ndier në adolehencën tënde, megjithëse i ke premtuar vetes se kurrë nuk do të ndodhte... por, ja që koha e jeta bën të vetën ndaj asaj dëshire shkulumuese për mos t’u ndalur edhe kur zemra pulsonte me galop dhe rreziku të tundonte si një akulllore në mes të zhegut. E kur mendoje se askush nuk të kuptonte. Të ftoj ta lexosh këtë libër për të mbërritur në mes të asaj ure komunikimi me fëmijën, nxënësin a çdo adolehent për të vijuar së bashku udhëtimin përmbushës të jetës.

Sonila Meço

MENDJE E SHËNDETSHME OSE FUNKSIONIM I SHËNDETSHËM PSIKOLOGJIK

Dr. Abaz Quka

Dr. Aida Quka



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928820860

Faqe: 324

Çmimi: 1500 lekë

PSIKOLOGJI

Jo më kot thuhet në popull: “Fjala shëron!”. Por edhe mendimi “shëron”. Një jetë të tërë si mjek kam kuptuar se jo çdo gjë arrihet vetëm me medikamente.

Prandaj e mora nismën të shkruaja këtë libër, i cili në thelb është një përmbledhje e ndërthurur e thënieve dhe metodave autosugjestionuese nga psikoterapistët më të shquar, gërshtuar me eksperiencën time personale ndër vite.

Mënyra se si ne reagojmë ndaj ambientit që na rrethon dhe situatave apo ndodhive është e ndryshme. Një pjesë e madhe e individëve, të rritur në familje të shëndetshme, kanë fituar që në moshë të vogël mekanizma të fuqishëm psikologjikë për një funksionim të shëndetshëm psikologjik, i cili i mbron ata nga sëmundjet mendore dhe i bën të përballojnë me sukses sfidat e jetës, qoftë edhe sëmundjet. Por jo të gjithë individët kanë një funksionim të shëndetshëm psikologjik...

ARTI PËR TË BËRË MIQ

Dale Carnegie



Botimet M&B
Publikimi: 2025
ISBN: 9789928851505
Faqe: 444
Çmimi: 1500 lekë

LIBËR MOTIVUES


Tetë gjëra që ky libër
do t'ju ndihmojë t'i arrini:

- 1 Hiqni dorë nga rutina mendore, jepuni pas mendimeve të reja, përqafoji vizioni të reja dhe zbuloni ambicie të reja!
- 2 Mësohuni të bëni miq shpejt e me lehtësi!
- 3 Mësoni ta rritni popullaritetin tuaj!
- 4 Bindini njerëzit për mënyrën tuaj të mendimit!
- 5 Mësoni ta rritni ndikimin, prestigjin dhe aftësitë tuaja për realizimin e synimeve që i keni vënë vetes!
- 6 Mësoni të trajtoni me durim e me drejtësi ankesat e të tjerëve, të shmangni debatet shterpe dhe të ruani marrëdhënie njerëzore të paqta e të këndshme!
- 7 Mundohuni të bëheni gjithnjë e më tepër një kuvendues më i mirë dhe një bashkëbisedues sa më zbatimës!
- 8 Përpiquni gjithmonë ta rritni entuziazmin mes bashkëpunëorëve që ju rrethojnë!

*Ky libër i ka parashtruar të gjithë këto parime mes dhjetë milionë lexuesve në 36 gjuhë të botës.

MISTERI: NEUROSHKENCA ME PAK FJALË

Adea Bajri



Botimet M&B
Publikimi: 2024
ISBN: 9789928820679
Faqe: 64
Çmimi: 700 lekë

PËR ATA FËMIJË QË DUAN
TË NJOHIN MISTERIN E
TRURIT

Ky libër është një udhëzues i thjeshtë dhe i kuptueshëm për të gjithë ata që janë të interesuar të kuptojnë trurin njerëzor. Me një gjuhë të lehtë dhe shumë shembuj, ai shpjegon funksionet, strukturat dhe proceset e trurit që kontrollojnë jetën tonë të përditshme.

Libri i drejtohet fëmijëve dhe adoleshentëve që duan të eksplorojnë misteret e neuroshkencës dhe të kuptojnë sesi mendimi, kujtesa, emocionet dhe lëvizjet formohen në trurin e tyre. Përmes pyetjeve interesante dhe informacionit të detajuar, ai krijon një lidhje të natyrshme midis shkencës dhe kuriozitetit të fëmijëve.

GERALDINA APPONYI – ZOGU MBRETËRESHA E SHQIPTARËVE NË SHTYPIN E HUAJ TË KOHËS (1938 – 1968)

Aurenc Bebja



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851062

Faqe: 268

Çmimi: 1000 lekë

HISTORI DOKUMENTARE

Mbretëresha Geraldinë e Shqiptarëve lindi më 6 gusht 1915 në Budapest. Prindërit e saj ishin konti Gyula Apponyi (1873-1924) dhe Gladys Virginia Stewart (1891-1947).

Bukuroshja hungareze martohet me Mbretin Zog me 27 prill 1938. Më 5 prill 1939 lind djalë e tyre, Mbretin Leka Zog 1. Më 7 prill 1939, Italia fashiste pushton Shqipërinë. Si rrjedhojë, ajo detyrohet të largohet në ekzil së bashku me Familjen Mbretërore, duke kaluar dhe jetuar nëpër disa shtete si Greqia, Turqia, Rumania, Polonia, Lituania, Letonia, Suedia, Norvegjia, Danimarka, Belgjika, Franca, Anglia, Egjipti, Spanja dhe në fund në Afrikë të Jugut, derisa u kthye përfundimisht në Shqipëri në vitin 2002. Trëndafili i Bardhë i Hungarisë shuhet më 22 tetor 2002, në moshën 87-vjeçare, në Spitalin Ushtarak të Tiranës. Ky libër, nëpërmjet dhjetëra shkrimeve të përmbledhura në shtypin e shkruar të kohës, ku secili mbart faqen, datën, ditën, vitin e botimit dhe emrin e gazetës apo revistës, dokumenton jetën e saj gjatë periudhës 1938 – 1968.

SHQYPTARËT

Kristo Floqi



POEZI, SHKRIME,
KORRESPONDENCE

Në kohën e pushtimit austro-hungarez kishte ardhur në Shkodër një baron maxhar, oficer i rezervës. Ai ishte shumë i interesuar për historinë e Shqipërisë dhe donte të bënte studime të veçantë në këtë fushë. Ndaj bisedat e tij me autorin kthehen në një poemë të fuqishme, e cila është aktuale edhe sot. Libri shoqërohet edhe më vështrime kritike rreth kësaj poeme, të cilat janë sjellë në këtë botim të përgatitur nga Henrik Kaçulini.

Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851048

Faqe: 312

Çmimi: 1500 lekë

TRI KOMEDI

Kristo Floqi



KOMEDI

Në këtë botim janë përfshirë tri komedi të Kristo Floqit: *Doktorllëket*, *Fat i papritur* dhe *Përfundimet e zilisë*. Këto komedi janë botuar në gazetën Telegraf në vitin 1927, dhe Java në vitin 1937. Janë transkriptuar dhe sjellënë këtë botim nga Henrik Kaçulini.

Botimet M&B

Publikimi: 2025


ISBN: 9789928851260

Faqe: 164

Çmimi: 1000 lekë

MISTERET E PELLAZGËVE I MISTERI DEI PELASGI


Leonida Anagnosti Ndrenika



Botimet M&B
Publikimi: 2025
ISBN: 9789928820822
Faqe: 96
Çmimi: 700 l ekë

HISTORI

Autori Leonida Ndrenika na zbulon në këtë libër, të mbuluar me mite dhe mister, pellazgët, që qëndrojnë si një nga kulturat e lashta më enigmatike të Evropës, me njohuritë e tyre shpirtërore dhe filozofike që formësojnë qytetërimet e ardhshme. Ky libër zbulon ritet e tyre të shenjta - si Misteret Eleusiniane dhe Kabiriane, ku kërkuesit nisën udhëtimin e transformimit, ndriçimit dhe bashkimit hyjnor. Nga tempujt e lashtë deri te mendimi bashkëkohor, trashëgimia e tyre vazhdon te popujt ilirikë, duke ofruar një urë lidhëse midis së shkuarës dhe së tashmes.



PINOKU

Karlo Kolodi



Botimet M&B

Publikimi: 2025

ISBN: 9789928851406

Faqe: 270

Çmimi: 1200 lekë

LETËRSI

Pinoku (Italisht: Pinocchio) është një personazh imagjinar dhe protagonist i romanit për fëmijë “Aventurat e Pinokut” i shkruar në vitin 1883 nga shkrimtari italian Karlo Kolodi (Carlo Collodi). Pinoku u gdhend nga një gdhendës druri i quajtur Xhepeto në një fshat toskan. Ai është krijuar si një kukull prej druri, por ëndërron të bëhet një djalë i vërtetë. Ai njihet për hundën e tij të gjatë, e cila rritet kur gënjen. Aventurat e këtij buratini nuk kanë fund...

Ai vjen si botim i plotë dhe i përkthyer mjeshhtërisht nga Bujar A. Kule, i ilustruar me vizatime nga Shpresa Kule.

GJEOPOLITIKA E REPUBLIKËS ISLAMIKE TË IRANIT

Dritan Demiraj



Botimet M&B
Publikimi: 2025
ISBN: 9789928820891
Faqe: 554
Çmimi: 2000 lekë

SIGURI

Libri “Gjeopolitika e Republikës Islamike të Iranit”, së bashku me dy librat e tjerë: “Strategjia Ushtarake e Iranit, forcat e armatosura dhe fuqia luftarake” dhe “Forcat Al-Quds, Struktura, misionet, operacionet dhe kapacitetet e tyre”, plotësojnë një studim gjithëpërfshirës të hollësishëm të gjithë strukturave politike, diplomatike, forcave të armatosura, të inteligjencës, sigurisë dhe të aktiviteteve të paligjshme dhe destruktive të Iranit në fushën e diplomacisë aktive, ekonomisë, teknologjisë, të sigurisë dhe të terrorit në të gjithë rajonin dhe botën, nën udhëzimin e drejtpërdrejtë të Liderit Suprem të Iranit Ajatollah Ali Khamenei.

STRATEGJIA USHTARAKE E REPUBLIKËS ISLAMIKE TË IRANIT: FORCAT E ARMATOSURA DHE FUQIA LUFTARAKE.

Dritan Demiraj




Botimet M&B
Publikimi: 2025
ISBN: 9789928851055
Faqe: 798
Çmimi: 2000 lekë

SIGURI

Libri “ Strategjia ushtarake e Republikës Islamike të Iranit”, së bashku me dy librat e tjerë: “Gjeopolitika e Republikës Islamike të Iranit” dhe “Forcat Al-Quds, Struktura, misionet, operacionet dhe kapacitetet e tyre”, plotësojnë një studim gjithëpërfshirës të hollësishëm të gjithë strukturave politike, diplomatike, forcave të armatosura, të inteligjencës, sigurisë dhe të aktiviteteve të paligjshme dhe destruktive të Iranit në fushën e diplomacisë aktive, ekonomisë, teknologjisë, të sigurisë dhe të terrorit në të gjithë rajonin dhe botën, nën udhëzimin e drejtpërdrejtë të Liderit Suprem të Iranit Ajatollah Ali Khamenei.

FJALOR ARMENISHT - SHQIP

Berzh Piranjani




Fjalor armenisht - shqip:
(rreth 59 000 fjalë) = Hayeren -
Albanakan Barraran : (shurj 59 000 barr)

Botimet M&B
Publikimi: 2025
ISBN: 9789928851239
Faqe: 896
Çmimi: 5000 lekë

FJALOR ARMENISHT - SHQIP

Berzh Piranjani



Fjalor armenisht - shqip:
(me fjalë Armene vetëm njërrrokëshe)

Botimet M&B
Publikimi: 2025
ISBN: 9789928851215
Faqe: 54
Çmimi: 500 lekë

Fjalor me fjalë të ngjashme
armenisht - shqip

Botimet M&B
Publikimi: 2025
ISBN: 978992885122
Faqe: 16
Çmimi: 300 lekë



SHIJE TË PËRJETSHME TIMELESS TASTES

Dhurata Thanasi



Ky botim është hartuar nga Fondacioni Shqiptar për Zhvillimin e Kapaciteteve Lokale (ALCDF), me autore Dhurata Thanasi, në kuadër të programit EU4Culture, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNOPS në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. .

Botimet M&B


Publikimi: 2025




ISBN: 9789928851352


Faqe: 160

Ky botim nuk është për shitje

BOTIMET M&B

 Rruga "Siri Kodra", P. "Planet X", Zona.Kad.8360, N.6, Tiranë

 0692068603  0686508441  mmbotime@gmail.com

 www.mmbotime.al  Botimet M&B  [botimetmb](https://www.instagram.com/botimetmb)